



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 20 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën për Zgjatjen e Afatit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Methju Haling

Valeria Boliçi

Xhejms Pac

Mbrojtjes së Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 9(5) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 shtator 2021, gjatë konferencës përgatitore të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), Trupi Gjykses i urdhëroi palët të diskutojnë problemet që kanë të bëjnë me klasifikimin e provave materiale në kërkesën e ZPS-së për pranimin e provave jogojore, me qëllim që të arrinin marrëveshje lidhur me llojin dhe sasinë e redaktimeve të propozuara, dhe ta informonin Trupin Gjykses lidhur me marrëveshjen që mund të arrijnë dhe problemet e pazgjidhura, nëse ka, deri më 20 shtator 2021 ("Urdhri").¹

2. Më 17 shtator 2021, ZPS-ja kërkoi të shtyhej deri më 24 shtator 2021 afati brenda të cilit palët duhej ta njoftonin Trupin Gjykses sipas Urdhrit ("Kërkesa").²

II. PARASHTRIME

3. ZPS-ja parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme që të miratohet zgjatja e kërkuar e afatit për shkak të sasisë së materialeve përkatëse dhe kohës që i nevojitet ZPS-së për të bërë redaktimet e propozuara si dhe Mbrojtjes për të shqyrtuar propozimet e ZPS-së.³

¹ Urdhër Gojor për Palët mbi Klasifikimin e Provave Jogojore të ZPS-së, f. 709, rreshti 25 deri te f. 710, rreshti 7 lidhur me F00298, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë lidhur me Klasifikimin e Provave Materiale në Kërkesën për Pranimin e Provave Jogojore*, 6 shtator 2021.

² F00315, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për Zgjatjen e Afatit ("Kërkesa")*, 17 shtator 2021.

³ Kërkesa, para. 2.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas nenit 40(2) të Ligjit, Trupi Gjykses mund të miratojë procedura dhe modalitete që janë të nevojshme për të mundësuar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procedurave.

5. Sipas rregullës 9(5) të Rregullores, Trupi Gjykses mund ta zgjasë afatin që kishte përcaktuar ai vetë, kur i paraqiten arsye të vlefshme.

IV. DISKUTIM

6. Fillimisht, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja ia dërgoi redaktimet e propozuara Mbrojtjes më 15 shtator 2021 dhe se Mbrojtja e informoi ZPS-në se do t'i nevojitej deri më 22 shtator 2021 që të jepte komentet e saj.⁴

7. Për këtë arsye dhe duke mbajtur parasysh, nga njëra anë, sasinë e materialeve përkatëse dhe, nga ana tjetër, kohën që i duhet ZPS-së për të bërë redaktimet e propozuara dhe Mbrojtjes për të shqyrtuar propozimet e ZPS-së, Trupi Gjykses është i mendimit se ZPS-ka ka treguar se ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e Kërkesës.

V. VENDIM

8. Për arsyet e sipërpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** Kërkesën; dhe për rrjedhojë
- b. **Urdhëron** palët ta informojnë Trupin Gjykses, deri më 24 shtator 2021, mbi ndonjë marrëveshje të arritur ose problem të pazgjidhur, nëse ka, lidhur me redaktimet e propozuara të provave të paraqitura në kërkesën e ZPS-së për pranimin e provave jогоjore.

⁴ Kërkesa, para. 2, poshtëshënimi. 4.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E hënë, 20 shtator 2021

Hagë, Holandë